

~~SECRET//NOFORN~~
 DPMO/KA/ROSOVA
 FORMER: PRAGUE
 CHINA: PRAGUE

02 No. 400/01-15248/25
1808-2025
Dragash - Dragash

VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash

Dëgjimi buxhetor ka filluar në ora 11:00 dhe ka përfunduar në ora 11:35.

Në këtë Dëgjim buxhetor kanë qenë prezentë **21 pjesëmarrës, prej tyre 15 meshkuj dhe 6 femra.**

Kryetari i Komunës së Dragashit, z.Bexhet Xheladini, e bëri hapjen e këtij takimi dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë dëgjim buxhetor.

Bexhet Xheladini: Sot e kemi debatin e fundit për Buxhetin, para se kryetari i Komunës ta çojë te kryesuesja e Kuvendit propozimin e Buxhetit për vitin 2026, si dhe projeksionet për vitet 2027-2028. Sot prezent këtu janë grupet e interesit, OJQ-të, shoqatat, klubet etj., të cilat bashkëpunojnë ngushtë që katër vite me Komunën e Dragashit. Siç e dini, Buxheti komunal nuk është buxhet i kryetarit të Komunës, as i Qeverisë Komunale. Është buxheti i qytetarëve. Dhe, siç e dini, lartësia e buxhetit caktohet në bazë të kriterëve. Unë po i përmendi disa. Kriteri kryesor është numri i banorëve. Siç e dini, Komuna e Dragashit ka pësuar një rënie të numrit të banorëve, në krahasim me vitet e kaluara. Për këtë arsye ne kemi edhe buxhet më pak. Gjithashtu, buxheti i Komunës ndahet edhe në bazë të sipërfaqes; pastaj nga përqindja e komuniteteve që jetojnë në Komunën e Dragashit, numrin e nxënësve, numrin e shkollave, numrin e çerdheve, numrin e objekteve shëndetësore etj. Kryetari i Komunës, duke u bazuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Pushtetit Lokal, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike, Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave, organizon debat publik me qytetarë dhe me grupe të interesit, për të marrë kërkesat, nevojat, sugjerimet, nga shpenzuesit e buxhetit, për t'i inkorporuar ato në buxhetin final, para se t'i shkojë Asamblesë për miratim. Qëllimi i miratimit të buxhetit është i shumëfishtë, por unë po i përmendi disa: përmirësimi i shërbimeve ndaj qytetarëve, pastaj zhvillimi ekonomik, avancimi i shërbimeve shëndetësore, ngritja e nivelit të arsimit, përmirësimi i infrastrukturës së Komunës, ngritja e përkrahjes për Kulturë, Rini dhe Sport, mbrojtja e ambientit, përkrahja e bizneseve, duke përfshirë këtu edhe ndihmat që i japim për bujqit dhe blegtorët, pastaj zhvillimi i turizmit, avancimi i barazisë gjinore dhe përkrahja e kërkesave të grave. Buxheti i Komunës së Dragashit për vitin 2026 është 13,254,881€; Granti për Arsimin është 4,741,000€; Granti për Shëndetësi 1,661,000€; Granti për Investime Kapitale është 4 milionë; Shpenzimet Komunale janë 400 mijë euro; dhe Subvencionet janë 400 mijë euro. Sa u përket subvencioneve, 90 mijë euro janë të parashikuara për Zyrën e Kryetarit, 100 mijë euro për bujqësi dhe blegtori, 150 mijë euro të parashikuara për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe 60 mijë euro për bursa. Nga gjithë ky Buxhet, 52% shkon për Paga dhe Mëditje, 12% për Mallra dhe Shërbime, 3% për Shpenzime Komunale, 3% për Subvencione dhe 30% për Investime Kapitale. Unë për fillim nuk dua ta zgjas më shumë, do t'ju lë kohë juve me e marrë fjalën dhe me dhënë propozime, vërejtje, sugjerime. Por, para se t'ju kaloj fjalën juve, e kisha lut drejtorin e Buxhetit që ta marrë fjalën.

Qamil Kolloni, drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim: Përsëritet për të gjithë Besoj se në pika të trasha kryetari pothuajse i tha të gjitha elementet të cilat duhet t'i bëjmë publike këtu dhe e bëri një përshkrim shumë të mirë të Buxhetit dhe ndarjeve buxhetore që i kemi për vitin 2026. Mua më duhet t'ju njoftoj se në këtë vit KAB-in jemi duke e miratuar dhe e kemi miratuar në Kuvendin Komunal pa miratimin e KASH-it. KASH-i është Korniza Afatmesme e Shpenzimeve të cilën e miraton Qeveria e Kosovës dhe e cila na dërgon Qarkoren Buxhetore, dhe në kuadër të saj na tregon për limitet e ndarjes së Buxhetit në të gjitha kategoritë: në Paga, Mallra dhe Shërbime, Investime Kapitale, Subvencione dhe Shpenzime Komunale. Mirëpo, si organizatë shpenzuese, në kuadër të Qeverisë që janë komunat, ne kemi edhe një rritje të lehtë, por me miratimin e Qarkores së Dytë Buxhetore, e cila shpresojmë të miratohet nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, presim të kemi një rritje të lehtë buxhetore. Por, pavarësisht atyre, në qoftë Qeveria dhe Kuvendi nuk mund t'i miratojë këto, ne në bazë të ligjit kemi të drejtën që, në bazë të shpenzimeve për vitin 2025 të funksionojmë si Komunë. Por, nuk do të kishim dashtë që të ndodhë kjo. Shpresojmë që institucionet tona të krijohen dhe t'i kryejnë të gjitha pjesët ligjore. Ne jemi munduar që të gjitha kategorive dhe të gjitha komuniteteve t'ua bëjmë një ndarje Fair Play, edhe për kokë banori, por edhe në bazë të vëllimit të punës, për të gjitha OJQ-të dhe klubet të cilat ekzistojnë këtu. Po e lexojmë Listën e e Investimeve Kapitale dhe pastaj po e hapim edhe diskutimin, çfarë ju mund të propozoni, keni përparësi, për arsye se në këtë dëgjim buxhetor keni mundësi të propozoni projekte të cilat ne nuk i kemi paraparë. Dhe, në qoftë se propozimet e juaja do të jenë të arsyeshme dhe kanë nevojë, se ne edhe mund të harrojmë diçka, mund të gjejmë mjete që t'i paraqesim, para se me i miratue në Kuvend Komunal. I keni edhe listat, besoj se jua kanë shpërndarë. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Faleminderit, drejtor Qamil! Siç e dini, prej se kam ardhë unë kryetar, një vëmendje të posaçme i kemi kushtuar ndihmës që i kemi thënë grupeve të ndryshme të interesit, sidomos OJQ-ve, klubeve dhe shoqatave. Këtë vit, përmes thirrjeve publike, janë subvencionuar 22 OJQ, klube dhe shoqata, dhe vlera e kësaj është 149 mijë euro. Ndërsa, për buxhetin e vitit 2026 kemi paraparë që për subvencione të ndahen, sa i përket DKRS-së, 150 mijë euro; për Zyrën e Kryetarit 90 mijë euro; për Bujqësi dhe Blegtori 100 mijë euro; dhe për bursa 60 mijë euro. Nëse e marrim total, për katër vite qeverisje, ne kemi ndarë subvencione në vlerë prej 1 milionë e 500 mijë euro. Unë këtu e kam edhe listën e OJQ-ve përfituese, por kjo është edhe publike, unë nuk kam nevojë me humb kohë – mund të hyni në uebfaqe me pa – pra bëhet fjalë për 22 entitete të cilat kanë marrë ndihmë nga Komuna. Tani fjala është e juaja, nëse do dikush me e marrë fjalën, me dalë me dhënë propozime, sugjerime, kërkesa etj.! Duhet të dilni këtu për shkak të përkthimit dhe duhet të prezantoheni se kënd e përfaqësoni!

Abaz Qengaj, OJQ “Kroi i Macës”: Faleminderit, kryetar! Ju përsërisht të gjithëve! Unë këtu përfaqësoj Abaz Qengaj, njëherësh edhe drejtorin e OJQ-së “Kroi i Macës”, dhe një qytetar ose një banor i fshatit Pllajnik. Thënë të drejtën, nuk merrem me ekonomi dhe numrat nuk i di shumë, por një pasqyrë e shkurtër, sikur ta kishim pas më herët, ndoshta do të kishim mund që ta elaborojmë më shumë këto gjëra. Por, në bazë të kësaj bisede që u bë nga drejtori dhe kryetari, shoh se ka gjëra të bukura dhe janë bërë gjëra të bukura gjatë këtyre viteve, si në kulturë, në infrastrukturë dhe gati gjithkund. Unë tani do të flas së pari si qytetar i fshatit Pllajnik. Në fshatin Pllajnik janë paraparë këtu kubëzim. Unë do të kisha thënë që të bëhen mure mbrojtëse dhe kubëzim, meqenëse kubëzim ka shumë më pak se sesa ka nevojë katundi për mure mbrojtëse të rrugëve të cilat përkrahin katundin. Si Abaz Qengaj, kam dhënë mjaft intervista në media të ndryshme, ne flasim për turizmin rural, kurse nuk bëjmë asgjë në drejtimin e turizmit rural. Gjithmonë kam thënë se kam një shtëpi që ka 170 metër katrorë, të cilën e kam lëshuar për shtëpi bujtinë në fshatin Pllajnik. Por, me një ndihmë ndoshta të vogël nga ministria apo nga Drejtorati i Kulturës dhe Sportit këtu, apo edhe nga Zyra e Kryetarit – shtëpia ka katër dhoma banimi, mund të banojnë brenda një nate 16 veta, ku kanë kushte të jashtëzakonshme, kanë odën, kanë kuzhinën, kanë katër dhoma dhe një banjo. Por, në këtë drejtim nuk është bërë asgjë. Kam shtëpinë e vjetër që kati përdhës është i lashtë mbi 300 vjet, kurse kati i parë është i shekullit të kaluar dhe është në rrënim e sipër. Kujtoj që një shtëpi të tillë nuk mund ta gjejmë në Komunën tonë. Dhe, unë mendoj dhe propozoj nga kjo foltore që dikush të merret dhe të bëjmë ruajtjen e asaj shtëpie, menjë investim jo kushedi sa të madh, dhe unë kujtoj se do shtohet vlera e Komunës sonë me një objekt jashtëzakonisht të lashtë. Unë nuk po due me e zgjat shumë, tash po flas në emër të drejtorit të OJQ-së “Kroi i Macës”. Mбай manifestimin tradicional “Sofra e Ymer Prizrenit” në Zgatar, në vendlindjen e të madhit Ymer Prizreni, një manifestim rutinë, çdo vit njësoj, me njerëz që vijnë nga të gjitha trojet shqiptare, vijnë edhe nga shtetet e tjera. Unë kujtoj dhe dëshiroj që, në bashkëpunim me DKRS-në, të ndërrojmë diçka dhe ta bëjmë “Ditët e Ymer Prizrenit”. Në të mendoj që të ketë një punëtori piktorësh që do të pikturojnë, një ditë apo dy ditë, varësisht sa do të mund t’i financojmë ata; të bëjmë pastaj dy Orë në Zgatar dhe Orën Letrare ta mbajmë këtu, në sallën e Kuvendit Komunal apo në objektin e kulturës atje, sepse zakonisht mund të na paraqiten probleme me motin e lig dhe është mëkat që të mos mbahet ora letrare kur vijnë pjesëmarrës nga treva të ndryshme. Buxheti të parashihet sa ka mundësi Drejtorati i Kulturës, mund të shtohet apo të ulët, tash kjo punë nuk varet nga unë. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Faleminderit! Sa i përket propozimit për fshatin Pllajnik, janë të parapara diku 62 mijë euro, edhe 5 mijë euro janë këtë vit, pra 67 mijë euro. 90% e këtyre mjeteve do të shkojnë për mure mbrojtëse. Është projekti, është shpallë tenderi, është nënshkruar kontrata, por vetëm 5 mijë

euro janë të parapara këtë vit, e mjetet tjera janë për vitin e ardhshëm. Kështu që, pjesa më e madhe e mjeteve do të shpenzohet për mure mbrojtëse. Sa i përket manifestimit “Sofra e Ymer Prizrenit”, është një term i cili është vu edhe para luftës, këtë ne si Komunë nuk mund ta ndërrojmë. Mund të quhet edhe “Ditët e Ymer Prizrenit”, mund të quhet edhe “Sofra e Ymer Prizrenit”. Në një vit e kemi bërë ashtu si e propozove ti, pra ka zgjat dy ditë manifestimi. Por, kjo është çështje e thirrjes publike, kur ta bëjmë vitin e ardhshëm mund ta bëjmë që të zgjasë dy ose tri ditë, nuk është problem.

Qamil Kolloni: Nëse më lejon një shpjegim. Të gjitha materialit që i keni këtu janë në uebfaqe dhe keni mundur t’i përcillni, sepse prej se është miratuar KAB-i janë në uebfaqen e Komunës, të gjitha dokumentet e publikuara. Gjithashtu, është edhe Lista për shpenzimet kapitale, por janë edhe të gjitha raportet e buxhetit dhe KAB-i. Kjo vlen për të gjithë qytetarët dhe ata të cilët janë të interesuar, se çdo dokument i cili ka për bazë elemente financiare, është i publikuar në uebfaqen e Komunës së Dragashit, në linkun Financat dhe Buxheti. Prandaj, mos hezitoni, mund t’i përcillni në vazhdimësi të gjitha këto, janë transparente.

Bexhet Xheladini: Faleminderit! Sa i përket shtëpisë, siç e dini, monumentet kulturore dhe historike janë kompetencë e qeverisë qendrore. Ju duhet të bëni një kërkesë në DKRS, pastaj kërkesa do të përcillet në Zyrën Rajonale për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në Prizren, dhe pastaj kjo zyrë merret me këtë çështje dhe e procedon në Prishtinë. Është një punë që kryhet pa problem. Qeveria e Kosovës në këtë drejtim ndan mjete dhe besoj që vitin e ardhshëm mund të fillojë procesi i konservimit të asaj shtëpie.

Halil Isufi, përfaqësues i KF “Opoja”: Përshëndetje për të gjithë! Ne si Klub Futbollistik “Opoja” sivjet e kemi buxhetin pak më të vogël, ndërsa shpenzimet po vijnë duke u rrit gjithmonë më shumë. Kemi me pas vështirësi për me funksionue. A ka ndonjë mundësi që, për një periudhë shumë të shkurtë, me mund me nda ndonjë pjesë të buxhetit, për me vazhduc klubi? Ju faleminderit!

Bexhet Xheladini: Në KF “Opojën” për çdo vit e kemi mbështet me mjete financiare jo të pakta. Në dy vitet e fundit e kemi mbështet me 34 mijë euro. Këtë vit kemi nda më pak, 22 mijë euro. Ju e dini që ju keni qenë në Ligën e Dytë, tash jeni në Ligën e Tretë. Edhe numri i ndeshjeve është më i vogël, edhe shpenzimet janë më të vogla, por e keni edhe një përparësi që tash e keni stadiumin ku mund t’i luani ndeshjet si mikpritës dhe nuk keni nevojë me bë pagesë. Por, megjithatë, vitin e ardhshëm do ta kemi parasysh, ndërsa për këtë vit do të shohim a do të lejohen mundësitë edhe buxhetore, edhe ligjore, me ju ndihmue. Por, unë do të jam gjithmonë në anën tuaj. Në bashkëpunim me ju, mund të dalim të lypim investitorë, donatorë, të cilët do ta ndihmojnë klubin. Sa herë ju të organizoni takime me biznese të Komunës sonë, më thirrni mu, unë do të jem mbështetës i juaj dhe do të kërkoj nga ata që të bëjnë subvencionimin e KF “Opoja”.

Beqir Beqaj, përfaqësues i Shoqatës së Afaristëve "Sharri": Përshëndetje! Ju e dini që jemi në prag të organizimit të Panairit tradicional me produkte lokale vendore. Desha të kem pas më shumë sqarim, se sivjet si do t'ia bëjmë, a do të jemi njëjtë, a do të organizohet njëjtë, a do të ketë ndonjë risi apo vizion për të ardhmen. Dhe, një propozim shtesë: mendoj se duhet të gjejmë një kohë, të ulemi bashkë dhe të bisedojmë për ndonjë aktivitet përtej panairit, gjatë kohës sa janë diaspora këtu, për të bërë diçka interesante. Sepse ju e dini që ne, përpos produkteve ushqimore që i ekspozojmë në panair, kemi edhe veshjet, kemi edhe turizmin, dhe për këtë arsye mendoj se duhet të bëjmë diçka shtesë, gjatë kohës sa qëndron mërgata jonë këtu. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Faleminderit! Sa i përket panairit, është viti i katërt që Komuna e Dragashit ndan mjete financiare për organizimin e panairit. Dy vitet e para kemi ndarë nga 12 mijë euro, vitin e kaluar edhe këtë vit kemi ndarë 13 mijë euro për organizimin e këtij panairi dhe kemi të paraparë edhe për vitet në vijim, që do të thotë se Komuna e Dragashit do të ndajë mjete të njaftueshme për thirrjen publike për panairin e produkteve vendore. Në thirrjen publike është potencue që të orientohemi më shumë sa i përket zhvillimit të turizmit.

Po e shoh që nuk ka të tjerë të interesuar. Me kaq e përfundojmë këtë debat të fundit publik, para se kryetari i Komunës t'ia dërgojë kryesueses së Asamblesë buxhetin përfundimtar, e cila pastaj do ta bëjë një takim me KPI'-në, dhe në fund do të thirret mbledhja e Asamblesë, në shtator, për miratimin final të buxhetit. Ju falënderoj për pjesëmarrje të gjithëve!

Linqet e lajmeve për mbajtjen e dëgjimit buxhetor, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:

Në uebfaqe:

[illegible]


Boshnjakisht: *koncepti dhe shprehjet e natyres se jetes dhe qytetimit te njeriut ne bashkezetet e reja te bashkuara*

Në Facebook:


Shqip: <http://www.scribd.com/document/10318348>

Boshnjakisht: *Shkollat e reja shkollore dhe shkolle te reja*

SHTOJCË: *Lista e pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë*



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Data/Datum: 12.08.2025

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal – Dragash/ Sala Skupštine Opštine - Dragaš

LISTA E PJESËMARRËSVE NË DËGJIMIN BUXHETOR ME GRUPE TË INTERESIT (BIZNESE, FERMERË, KLUBE SPORTIVE, OJQ, KLUBE KULTURORE ETJ.)

LISTA UÇESNIKA NA BUDŽETSKO SASLUŠANJE SA INTERESNIM GRUPAMA (PREDUZEĆA, POLJOPRIVREDNICI, SPORTSKI KLUBOVI, NEVLADINE ORGANIZACIJE, KULTURNI KLUBOVI ITD.)

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Etnia Etnička pripadnost	M	F	Nënshkrimi
Br.	Ime i Prezime	Prebivalište		M	Ž	Potpis
1	Emredin Haxhi	Dragash	Shqiptare		✓	
2	LIRI DONA MUJINAJ	PLAC	SHQIPTARE		✓	
3	Kaduna Koshvri	Dragash	Shqiptar		✓	
4	LINDITA ZIENAJ	Dragash	Shqiptar		✓	
5	Abet Gencay	Plac	Shq.	✓		
6	HALLI TSUAJ	BRAC	SHQIPTAR	✓		
7	Ibrahim Dzatoe	Brac	Goranac	M		
8	Dzabe Mehmed	Globocica	Goranac	M		
9	SALIF ZECIRI	Radezh	Goranac	M		
10	MURH MUŠKI	RESTECI		M		
11	BEQIR BEQIR	BRAC	SHQIPTAR	M		
12	Ferid Haxhi	BRAC	SHQIPTAR	M		
13	DALTON ZESHUJANU	BRAC	SHQIPTAR	M		
14	LEONIDA MISHI	SHANE	SHQIPTAR		F	
15	ECENI LUPATI	BRAC	SHQIPTAR	M		
16	Artan Jonuzi	BRAC	SHQIPTAR	M		
17	ARON KALANDE	KOSOV	SHQIPTAR	M		
18	ADHAN MUTAT	RESTECI	BOSNALL	M		
19	PRANIN SYLJANU	BRAC	SHQIPTAR	M		
20	FAR KOLLONI	KOSOV	SHQIPTAR	✓		
21	MURAT RASHI	BRAC	SHQIPTAR	T	F	
22						
23						
24						

REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 Komuna e Dragashit
 Opština Dragaš

02 Nr. Br. 400/01-15248/25
 12.08.2025
 Dragash - Dragaš

